

# TRAJNIM ONLINE

## Përdorimi I TIK-ut nga nxënësit në shtëpi. (1 kredit)

Pas përjetimit të mësimit në distancë tani sfida është organizimi sa më efektiv të mësimit në klasë dhe mësimit në shtëpi.

Si mundet ti përgatisim nxënësit tanë nëpërmjet një sistemi që mbështet dhe ndërthur të dy mësimeve nëpërmjet përdorimit të pajisjeve digjitale nga shtëpia?

Na ndiqni në trajnimin e radhës.

Nr i krediteve: 1 kredit

Tarifa: 1500 lekë

Tel: 0695816410



Cfarë e bënë më EFEKTIVE mësime/ nxënësit?

Përfitimet e TIK-ut në mësime/nxënësit

Udhëzim për mësime/nxënësit.



Litaraturën përkatëse që pjesëmarrësit do të studiojnë dhe përdorin.

Shëmbuj konkret të përdorimit të mjeteve digjitale sipas metodologjive.

Detyrat për pjesëmarrësit që do të kryhen gjatë /pas zhvillimit të modulit.

Metodat që do të përdoren për secilën seancë të trajnimit.

# MODULI: Përdorimi I TIK në mësimdhënie/nxënie.



Cfarë e bënë më EFEKTIVE  
mësimdhënien/ nxënien?



Përfitimet e TIK-ut në  
mësimdhënie/ nxënie



Shëmbuj te praktikave.



# Metodologjia

Rubrika e metodologjisë së zbatimit të këtij moduli përmban:



Litaraturën përkatëse që pjesëmarrësit do të studiojnë dhe përdorin.

Mjetet mësimore për konkretizim sipas metodologjise.

Detyrat për pjesëmarrësit që do të kryhen gjatë /pas zhvillimit të modulit.

Metodat që do të përdoren për secilën seancë të trajnimit.

Prezantimi I secilit pjesemarrës:

<https://docs.google.com/presentation/d/1otkYbGRLZ3oa3bDjxS4HuXXJflirELONCT3u4pAK6hE/edit?usp=sharing>

**Erviola Konomi**

*Në mars për shkak të pandemisë, mësuesit filluan të zbatonin mësimin në distance si mundesi e vetme e momentit.*

**Ndërsa tani sfida është zhvillimi sa me efektiv te organizimit të mësimdhënies mes mësimin në klasë dhe mësimin në shtëpi.**

**Për më tepër, në shumë raste, mësuesit duhet të veprojnë në një kontekst hibrid duke mësuar si nxënësit që janë në klasë ashtu edhe nxënësit që janë në shtëpi.**

- *Pyetja është, si mund të përgatitemi për një sistem që mund të mbështesë dhe ndërthur të dy mësimdhëniet? .*
- *A mundet që të mësuarit aktiv të mbijetojnë në mjediset në klasë ku ndërveprimi i nxënësit është i kufizuar nga protokollat e distancës fizike?*
- *A mund t'i angazhojmë nxënësit në një mjedis të largët si sinkron ashtu edhe asinkron?*

Do të shqyrtojmë përgjigjet dhe zgjidhjet e mundshme për t'u fuqizuar për sfidat aktuale.

<https://www.menti.com/2q4izfigvn>

[www.mentimeter.com](http://www.mentimeter.com)

Krijon prezantime dhe takime interaktive, kudo që të jeni.

Përdoret për sondazhe të drejtpërdrejta, kuize, re konceptuale të fjalëve, pyetje dhe përgjigje dhe më tepër për të marrë informacion në kohë reale - pavarësisht nëse jeni fizikisht largë, hibrid apo ballë për ballë.



**Pëshkruani me një fjalë të vetme foton.**

<https://answergarden.ch/1594492>



**Erviola Konomi**

## Pëshkruani me një fjalë të vetme foton.

Qasja e mësimdhënësve duke përdorur

- metodën tradicionale të punës,
- mësuesi në qendër dhe
- dhënia e informatave duke u bazuar vetëm në pjesën teorike të materialeve

është edhe një ndër faktorët që ndikon në pasivizimin e nxënësve dhe në mos stimulimin e tyre për punë.





Fakti i pakëndshëm:

- Nxënësit nuk mësojnë gjithmonë atë që mësuesit shpjegojnë.


### - Çfarë është të mësuarit?

- Të mësuarit është një ndryshim në kujtesën afatgjatë (Kirschner et al., 2006)

Filozofia e kurrikulës së re të arsimit bazë është bazuar në qasjen konstruktiviste.

Kjo qasje përkufizon: **"të mësuarit ndodh kur personi ndërton së bashku mekanizmin për të mësuar dhe versionin e tij unik të dijeve, plotësuar këto me përvojat dhe aftësitë e tij personale"** (Roblyer, 2006)

Sipas kësaj qasjeje dija ndërtohet, nuk transmetohet ndaj nxënësi gjeneron dije të reja nëpërmjet aktiviteteve, përvojave dhe eksperimenteve.



Qasja konstruktiviste përfshinë komunikimin e informacionit nga mësuesi tek nxënësi, nga nxënësi tek mësuesi, nga nxënësi tek nxënësi.

**Erviola Konomi**

Pyetje kritike për mësuesit.

**"A është përdorimi i teknologjisë dixhitale me vlerë të shtuar në mësimdhënien time dhe në përvojën e të mësuarit të nxënësve të mi? "**

<https://www.menti.com/ezpi4xq8wx>

Pse duhet të përdorim TIK në mësimdhënie/nxënie?

**Përfitimet e TIK-ut në mësimdhënie.**

TIK-u si aftësi funksionale e leximshkrimit digjital, nxit dhe zhvillon tek nxënësit disa aftësish.

- Aftësi matematikore
- Aftësi komunikuese
- Aftësi të menduarit kritik dhe të zgjidhje së problemeve.
- Aftësi për të punuar në grupe.
- Aftësi për të përdorur një shumëllojshmëri burimesh.

Rritë aftësin konceptuale dhe perceptese të nxënësit.

Lehtëson të nxënit

Sjell dinamizëm në mësimdhënie/nxënie


I vendos nxënësit në kontroll për të nxënit e tyre, si progres zhvillimi I pavarur.

Sjell dinamizëm në mësimdhënie/nxënie

Ndihmon nxënësit me aftësi ndryshe në arsimin gjithëpërfshirës.

## Si paraqitet gjendja në Shqipëri?

Sipas Eurydice një rrjet që rrit bashkëpunimin evropian në arsim duke zhvilluar shkëmbime informacioni rreth sistemeve dhe politikave arsimore, duke prodhuar studime për çështje të përbashkëta për sistemet arsimore, paraqet qasjet e kurrikulës për mësimdhënien e kompetencave dixhitale sipas kurrikules kombëtare për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët, (ISCED 2), 2018/19 kemi ilustrimin në foto.



- Ndërkurrikulare
- I detyrueshëm në lëndë të veçantë
- Integruar në të tjera lëndët e detyrueshme
- Të tre qasjet

Erviola Konomi

Në kurrikulën e re të hartuara në kuadër të rishikimit të kurrikulës aktuale për sistemin tonë arsimor, kompetenca digjitale është një ndër shtatë kompetencat kyçe e cila integrohet në të gjitha lëndët e arsimit bazë dhe të mesëm të ulët.

## Cilat janë kompetencat që duhet të zotërojë mësuesi për realizimin e situatave të të nxënit duke përdorur teknologjinë në orën mësimore sipas dokumenteve të Unesco-s?

Për të kryer operacionet bazë me hardware dhe software si dhe aplikimet e menaxhimit të informacionit mësuesit duhet :

- ✓ të përshkruajë dhe demonstrojë funksionet bazë dhe të përdorë word processorët ;
- ✓ të përshkruajë dhe demonstrojë qëllimin dhe cilësitë kryesorë të softëware-ve të prezantimit dhe resurseve të tjerë digjitale;
- ✓ të përshkruajë qëllimin dhe funksionimin e software-eve grafike dhe të përdorë një paketë software-ike grafike;
- ✓ të përshkruajë Internet-in dhe World Wide Web, si dhe të tregojë si funksionon një browser (shfetues) ose si përdoret URL për të aksesuar një website;
- ✓ të përdorë një motor kërkimi (search engine) dhe të demonstrojë kërkimin e website-eve;
- ✓ të krijojë një llogari e-mail-i dhe ta përdorë atë;
- ✓ të lokalizojë dhe skedojë paketat software-ike të edukimit dhe t'i vlerësojë ato për nga saktësia dhe përputhja me kurrikulën shkollore;

**Cili eshte mjete qe keni perdorur me pare  
gjate mesimdhenie tuaj?**

<https://www.menti.com/6p03tmgbve>

## Kur fillojmë të planifikojmë mësimin duhet të kemi parasysh:

### ✓ Çfarë nxënësi di ?

Ne mund ta përdorim këtë pyetje në fillimet e temave, por edhe në jetën e përditshme, kështu që mund të kontrollojmë se çfarë nxënësit po mësojnë.


### ✓ Çfarë dëshirojnë nxënësit të mësojnë?

Mund ta përdor për të njohur intereset e nxenesve, por si progres i njohurive, nëse i pyet çdo ditë, ata kanë interesa të reja.


### ✓ Çfarë kanë mësuar?

Ju mund të përdorni pyetjet për të vlerësuar nxenesin në fundi, por gjithashtu në fund të çdo mësimi pyetjet e hartuar qart dhe saktëdo t'ju ndihmojnë të dini si të filloni mësimin tjetër

## Kur fillojmë të planifikojmë mësimin duhet të kemi parasysh se:



Rutinat e të menduarit janë strukturat themelore që e bëjnë nxënësin të mendojë në një mënyrë të strukturuar për një temë.



Kur mendojmë të fillojmë një temë mund të marrim informacione të rëndësishme që lidhen me njohuritë dhe intereset e nxënësve.



Ne mund t'i përdorim të gjitha këto informacione për të ridizenjoni idetë e temës për tu ofruar nxënësve më të mirën.




## Cfarë e bënë më EFEKTIVE mësimdhënien/ nxënien?

Si pas Piramides DALE nxënësit mbajnë mend sipas veprimtarive të të nxenit...

Mësuesve u nevojiten (80%) shprehi jo teknike dhe (20%) shprehi teknike.

Thelbësore është pavarësia dhe puna në grupe PER TE KRIJUAR NJE MODEL NGA JETA REALE.

Shprehitë baza të nevojshme (të lexuarit, të shkruarit, skicimi) dhe shprehi të tjera të nivelit të lartë të njohjes janë kushte paraprake për një përdorim të suksesshëm të TIK-ut.



Po ti referohemi udhëzimit  
(Udhëzuesi me situatë të të nxënit  
me TIKun, Prill 2015)

Mësuesi sot përballlet me një sërë zgjedhjesh të reja që kërkojnë përgjegjësi profesionale në lidhje me mënyrat e integritit të TIK-ut gjatë veprimtarive/aktiviteteve mësimore në klasë dhe jashtë saj.



Ashtu si mësuesi zgjedh metodologjinë e duhur dhe efektive për të arritur rezultatet e dëshiruara të të nxënit, ashtu ai duhet të përzgjedhë dhe komponentët e opsionet më të mirë të teknologjisë së komunikimit të informacionit të cilat përmirësojnë metodologjinë e mësimdhënies dhe përshtaten më së miri me nevojat e nxënësve.







Orientim per nxenesit.

# Te mesosh nga shtepia






## DISKUTIM: PERSHKRUAJ FOTOT



# FLIPPED CLASSROOM



[https://youtu.be/l\\_UdgYTO6bc](https://youtu.be/l_UdgYTO6bc)

KLASA TRADICIONALE

Traditional classroom


Flipped classroom

Student independent study

Teachers and students engage with content

Teachers transmit content

Student independent study



KLASA FLIPPED

# FLIPPED CLASSROOM



# The Flipped Classroom

DURING



NE KLASË

Nxenesit vene ne zbatim konceptet kyc nepermjet reagimeve.

GOAL

Nxenesit pergatiten qe te marri pjese ne aktivitetet e klases.

BEFORE



GOAL

Nxenesit kontrollojne dhe zgjerojne te mesuarin e tyre

AFTER



GOAL



JASHTË KLASËS



Flipped classroom eshte nje lloj i te mesuarit te perzier qe permbys te mesuarin tradicional duke dhene udhezime mbi permbajtjen zakonishte online, jashte ambjentit te klases



# Taksonomia e re e Bloom-it e permbysur qe ndjek ne Flipped learning ne klasat e permbysura



# BLOOM taksonomi

QENDRIME

SHKATHTESI

NJOHURI

## Veprimtarit e te nxenit

**Të krijuarit:** Vendosja sëbashku elementët për të formuar një tërësi funksionale; riorganizimi i elementëve sëbashku në një model ose një strukturë të re përmes gjenerimit.

**Të vlerësuarit:** Dhënia apo bërja e gjykimeve të bazuara në kritere dhe standarde përmes verifikimit dhe analizës kritike.

**Të zbatuarit:** Zbatimi përmes ekzekutimit ose plotësimit. Nxenesi duhet të jete në gjendje që informacionet e marra të zbatohen për të zgjidhur probleme në situata konkrete

**Të analizuarit:** Ndarja e materialit në pjesë përbërëse, përcaktimi si lidhen pjesët me njëra tjetrën përmes dallimeve, organizimit dhe vetive. Materialin e dhënë ta zberthejnë në pjesë dhe të kuptojnë strukturën në perberje të saj.


**Të kuptuarit:** Ndërtimi i kuptimit nga mesazhet zanore, të shkruara apo grafike përmes interpretimit, ilustrimit, klasifikimit, përmbledhjes, krahasimit dhe shpjegimit.

**Të kujtuarit :** Rikujtimi, rinjohja dhe riprodhimi i njohurive përkatëse nga kujtesa afatgjatë

BLOOM taksonomi në klasat e permbysura

## Një situatë.

Mesuesja u dergoi nxenesve dhe Mires disa video per temen mesimore “Veprime me numra”. Pasi pa materialet qe dergoi mesuesja, Mira memorizoi informacionin, mbajti shenime. Dhe me pas kur erdhi ne klase punoi me pyetjet dhe kur haste pengesa pyeste mesuesen ta ndihmonte ate.



## Avantazhet dhe dizavantazhet e një klase të kthyeshme (Flipped classroom)

**Avantazhet** Pse Flipped classroom shumë efikase?

- Përqendrohet mesimdhenia me ne **qender nxenesin** dhe **bashkepunimin**.
- Mesimet dhe permbajtjet jane te lehta per tu **aksesuar**.
- Nje Flipped classroom u ofron nxenesve perfitimin e **nje kontrolli me te madh** mbi te mesuarit e tyre.
- Nxenesit drejtojne diskutimin ne klase per te kerkuar sqarim nga mesuesit, keshtu qe **nevojat e tyre** drejtojne mesimin.
- Kur kryejne eksperimente praktike dhe **praktikojne aftesi te reja** ne klase, nxenesit mund te kenë më shumë autonomi.
- Nxenesit eksplorojne **koncepte te reja ne menyren e tyre**, me ritmin e tyre, ne një mjedis të kontrolluar nga prinderit dhe mbështetësit.
- Kjo e bën, pasi **diferencimi ndodh natyrshëm** dhe nxenesit mbeten të angazhuar.

## Dizavantazhet

Flipped classroom mbështetet shumë në teknologji dhe nxenesit kanë nevojë për të hyrë në internet në shtëpi, për të mësuar.

Kjo mund ta bëjë ndarjen dixhitale midis nxenesve të cilet kanë mundesi për paisje teknologjike dhe nxenesit të tjere më të varfër, pa qasje në teknologji për të hulumtuar.



## Katër shtyllat e F-L-I-P

### Përse një Flipped classroom?

Mbani në mend katër shtyllat e F-L-I-P ndërsa planifikoni mësimin tuaj.

#### **F: (Flexible learning environment)** **Mjedisi fleksibël i mësimit**

Mjetet duhet të jenë të tilla dhe të lejojnë një larmi **pune në grup dhe individuale**. Koha e mësimave duhet të jetë **fleksibël** për t'i lejuar nxënësit të eksplorojnë plotësisht një temë dhe ta kuptojnë atë me ritmin e tyre, duke ju kthyer videos/materialit disa here.

#### **L: (Learning culture)** **Mësojnë në forma të ndryshme.**

Në vend të mësimit tradicional me në qendër mësuesit, flipped classroom i vendos **nxenesit në qendër** të mësimit. Nxenesit drejtojnë ritmin dhe stilin e të mësuarit, dhe **mesuesit** luajnë rolin e "**udhëzuesit në krah**". Mesuesit do t'i ndihmojnë nxenesit përmes një eksperimenti ose do t'i drejtojnë ata përmes një praktike të caktuar kur kanë nevojë për ndihmë duke aplikuar njohuri të reja.

#### **I: (Intentional content)** **Përmbajtja e qëllimshme**

Flipped classroom është qasje që gjithmonë është në kërkim të mënyrave për të **maksimizuar kohën e tyre në klasë** në mënyrë që nxenesit të angazhohen në mënyrë aktive në mësim dhe zbatim praktike. Pra gjetjen e mënyrave për të inkurajuar **nxënësit të punojnë të pavarur**.

#### **P: (Professional Educator) Edukator Profesional**

Modeli kërkon që mesuesit të monitorojnë vazhdimisht nxenesit e tyre në mënyrë që të **identifikojnë se kush ka nevojë për ndihmë, me çfarë dhe pse**. Mesuesit duhet të jenë të përgjegjshëm dhe fleksibël dhe ata duhet të kuptojnë se ky stil shumë aktiv i mësimdhënies kërkon aftësi të mëdha pedagogjike.

# FLIPPED CLASSROOM ACTIVITIES FOR THE COLLEGE CLASSROOM

Did they say it was all about videos? Well, that's not right. You can flip in many ways.



## Klasë përgatitore

### Aktivite hyrese.

Ndani materiale tekstuale, audio, video me nxënësit dhe bëjini ata të përgjigjen për kuloet parapërgatitore për të testuar gadishmerinë.



Individual/ Group Preparation Online

### Diskutime në kl përgatitore.

Ndani me nxënësit një material dhe i përfshini ata në diskutime online duke përdorur forume, Msg, Twitter, Google classroom etj



Group Preparation Online

### Plan vizual instruksionesh.

Formulojini rezultatet e të nxenit, pyetjet esenciale, fjalat kyç nepermetj një plani instruksionesh që ndihmon nxënësit ta shikojnë mësimin si bashkësi pjesezash.



Professor Activity Preparation Online

Visit [www.acadly.com](https://www.acadly.com) for our infographic on how to use 100% effectively.

### MAT PËRGATITJEN

Efektiviteti i në klasën përgatitore lidhet me përfshirjen e nxënësve në mësimin e përmbajtjes. Gjurmë progresin e nxënësve.



Individual Assessment Online

## Në klasë

To enhance problem solving, organization, and collaboration skills.

### Pyetsor dhe debate

Krijoni një pyetsor dhe filloni rotacionin. Përdor rezultatet e pyetsorit për të faktuar dhe statuar nje debat, i cili mundet te vazhdoj dhe online.

Individual/ Group Preparation Online



Visit [www.acadly.com](https://www.acadly.com) for our infographic on "10 ideas on how to use polls in the classroom"

### Krijoni grupet.

Ndani nxënësit në grupe me nga 4-5 nx për të ndarë njohurit e tyre me njeri-tjetrin. Gjithashtu të gjithë nxënësit ndajnë idet e tyre në forumet e përbashkëta.



Group Preparation Online/ Offline

Kanalizimet  
Krijoni kanalizime ku nxënësit të ndajnë mendimet dhe të shtrojnë pyetje për diskutimet si verbale dhe online.



Individual/ Group Preparation Online/ Offline

Visit [www.acadly.com](https://www.acadly.com) for our infographic on how to use Backchanneling in the classroom

Vlerësimi në klasë.  
Vlerëroni nx për pjesëmarrjen në aktivitetet offline, si psh shtrimi i pyetjeve dhe krijimin e prezantimeve.



Type Objective Best Estimated  
Individual Assessment Online

## Aktivitetet



Visit [www.acadly.com](https://www.acadly.com) for our infographic on 7 Tech-enabled variations of Think-Pair-Share

Përgatit vlerësimin dhe adresoj dyshimet.

Pas - Klasës

Përdor teknika të përgjithshme për të kontrolluar të nxenit në fund të procesit. Bëj disa pyetje dhe diskuto përgjigjet në klasën e ardhshme online.



Type Objective Best Estimated  
Individual Assessment Online/ Offline

Visit [www.acadly.com](https://www.acadly.com) for our infographic on how to use Exit Tickets effectively

Sondazhi i opinionit  
Starto një sondazh për nxënësit, që ka mundësi të lidhet me një problem/ çështje. Mblidhen opinionet dhe diskutohen rezultatet.



Type Objective Best Estimated  
Individual Assessment Online

Visit [www.acadly.com](https://www.acadly.com) for our infographic on "10 ideas on how to use polls in the classroom"

## Analizo, bashkëvepro.

Duhet të jeni të drejtuar nga të dhënat në qasjen tuaj. Fokusohuni në 4 parametëra. Përgatitja, pjesëmarrja, aktivizimi, performanca.



Type Objective Best Estimated  
Professor Activity Assessment Online

Acadly helps you deliver engaging learning experiences before, during, and after class. It is mobile, easy to use, and free!

Visit [www.acadly.com](https://www.acadly.com) for the complete blog post and references.



## Si të rrokullisni (flip) klasën tuaj

Nëse jeni gati të filloni të përdorni modelin e flipped learning, ndiqni këto hapa:

### 1. Përcaktoni teknologjinë tuaj



Flipped learning mbështetet shumë nga teknologjia për të krijuar dhe shpërndarë video të leksioneve, ndaj zgjedhja e teknologjisë që ju ndihmon më së miri të filmoni, modifikoni dhe ndani videot tuaja është një hap i parë thelbësor. Ju gjithashtu do të duhet të regjistroni një përmbajtje dhe të përcaktoni se si nxenesit tuaj do të kenë qasje në të gjithë përmbajtjen tuaj. Për më tepër, do t'ju duhet të gjurmoni progresin. (YouTube, Onedrive, Dropbox, etj?)



## 2. Krijoni videot dhe përmbajtjen tuaj

Ju do të befasoheni kur te mësoni se ajo që duhej 15 minuta për të shpjeguar zakonisht në një mësim, mund të vendoset në një video pesë minutëshe, pasi nuk do të shqetësoheni për menaxhimin e klasës.

Mos kini frikë të jeni argëtues! (Snagit, Kinemaster, etj)




### 3. Jini Transparencë me nxenesit dhe prindërit

Para se të filloni, sqaroni qartë se çfarë është flipped learning dhe pse po e bëni atë. Të bësh një ndryshim të madh në kulturën e bashkeveprimit në klasë është punë e vështirë dhe të rishikosh mendimin nuk është e lehtë. Jini të gatshëm të adresoni shqetësimet dhe të rishikoni shpesh "si" dhe "pse".

### 4. Ndani

Dërgojeni videon nxenesve tuaj. Bëni tërheqës dhe të qartë. Shpjegoni që përmbajtja e videos do të diskutohet plotësisht në klasë.



## I bëni nxënësit tuaj të përgjegjshëm.

Sigurohuni që të krijoni një sistem që gjurmon dhe mban nxënësit përgjegjës për shikimin e videove tuaja.

Për ta bërë këtë mund të përmendim psh kuize të shkurtra formuese në fillim të një mësimi. (QUIZZIZ, SURVEY, MENTIMETER, GOOGLE FORMS, etj). Këto do t'ju ndihmojnë të përcaktoni se cilët nxënës i kanë bërë detyrat e shtëpisë, cilat jo dhe kush ka nevojë për ndihmë.



## 5. Gruponi

Një mënyrë efektive për të diskutuar temën është të ndaheni në grupe ku nxenesit u jepet një detyrë për të kryer. Shkruaj një poezi, një dramë, bëj një video, etj. Nxenesit mund të mësojnë njëri-tjetrin duke shpjeguar koncepte ose duke punuar në probleme të vogla.



## 6. Rigruponi

Bashkoni klasen perseri për të ndarë punën e grupit individualishte me të gjithë. Bëni pyetje, thellohuni ne njohuri. Aktivitetet e të nxënit në bashkëpunim mund të rrisin angazhimin e studentëve, të rrisin kuptimin e studentëve dhe të promovojnë inteligjencën kolektive

- Diskutime ose debate
- Te artikulojnë mendimet e tyre në vend
- Të zhvillojnë argumentet e tyre në mbështetje
- të mendimeve ose pretendimeve të tyre



## Aktivitete në klasën Flepped classroom


Provoni këto veprimtari në klasën flepped classroom si një pikë tërheqëse për mësim me krijuese.

### Kontrolli I përgatitjes.

Duhet që nxenesit të vijnë në klasë me informacionin bazë që u nevojitet dhe materialet e detyrave të shtëpisë të jenë tërheqëse.

Mësuesit mund të krijojnë aktivitete të gamifikuara të vlerësimit formues për studentët e tyre duke përdorur Quizizz dhe t'i caktojnë këto aktivitete.

Planifikoni të filloni mesimin me një vlerësim të shkurtër në **Quizizz** për t'u siguruar që të gjithë janë gati. Mund të jetë një problem i vetëm për të zgjidhur, një studim smartphone ose klikues, ose një pyetësor i shpejtë që e rishikoni në kohe reale.



# Gjenerimi i pyetjeve

Seanca aktive të pyetjeve dhe përgjigjeve, ose Brainstorming që realizohet në ([Mind Meister](#), [Padlet](#), [MIRO](#), etj).


I bëni nxenesit të shkruajnë pyetje në një tabelë ose tabak të bardhë, ose të sigurojnë pesë pyetjet më të mira dhe bëni që nxenesit të votojnë përmes afisheve për ato që duan t'u përgjigjen. (**Linoit**). Mund ndani nxenesit në grupe për të ndihmuar njëri-tjetrin që të plotësojnë boshllëqet





**Padlet:** Pasi nxënësit të kenë parë një video udhëzuese, siguroni atyre një mundësi **për të reflektuar** në përmbajtje. Padlet u ofron mësuesve një mënyrë për t'i bërë nxënësit jo vetëm të rishikojnë dhe reflektojnë mbi përmbajtjen, por edhe **të bashkëpunojnë** me shoket e tyre.

Mësuesit mund të krijojnë një mur të ri Padlet për secilën video ose njësi dhe të inkurajojnë nxënësit të bëjnë pyetje dhe t'u përgjigjen pyetjeve të 674504130 të tyre në lidhje me përmbajtjen si një përmbledhje për **vlërësimet** e njësive.





**RUBRIKA E DISKUTIMIT.** Pyetsor për mësuesit:  
**ZBATIMI I TEKNOLOGJISE NE MESIMDHNIE**

<https://forms.gle/fGB5YzBcgxG1A7nd6>

## Leksioni II


" Çfarë duhet të japim mësim? "  
Mësuesit vendosin për mënyrën  
se si do ta realizojnë procesin e  
mësimindhënies/nxënies me  
apo pa përfshirjen e  
teknologjisë.

Ata përcaktojnë rezultatet e të nxënit  
që duhet të arrijnë gjatë orës së  
mësimit, metodat dhe veprimtaritë  
që do t'i përdorin në orët e tyre  
mësimore për arritjen e rezultateve  
të të nxënit.

Rezultatet e të nxënit janë arsyeja  
pse një mësim po mësohet.



## Formati i situatës/ orës së mësimi/veprimtarisë së të nxënit



## ROLI I MESUESIT

### MESUESI:

Gjen mjetin digjtal, zgjedh dhe menaxhon informacionin - në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi

Krijon përmbajtjen akademike DIGJITALE (çfarë duhet të mësojnë nxënësit)

- A është përmbajtja mësimore e vlefshëm? (A janë rezultatet e të nxënit të qarta, të lidhura me kompetencat kyçe dhe nivelet e arritjes së nxënësve)
  - Përcakton komunikimin dhe bashkëpunimin në klasë ose ONLINE - në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi
  - Siguria ONLINE
- Qëllimet mësimore (rezultatet e të nxënit), metodat dhe veprimtaritë (se si ta japi përmbajtjen akademike)

### A e angazhojnë nxënësin veprimtaritë e përzgjedhura mësimore?

- Zgjidhja e problemit - Reflektimi mbi të mësuarit
- Vlerësim i rezultateve të të nxënit (si ta dimë se çfarë nxënësit kanë përvetësuar)

**Sa e ka përmirësuar teknologjia mësimin në mënyrë që pa të, nuk do të ishte e mundur?**

## SHEMBULL TE NJE SITUATE

Planeti ynë, toka, po ndryshon për shkak të ndryshimit të klimës. Adresimi i ndryshimit të klimës do të jetë një sfidë, dhenxenesit mund të kontribuojnë te projektimi dhe implementimi i zgjidhjeve të ardhshme.

Propozohen katër aktivitete të lidhura:

### *1. Plotëso mozaikun!*

Në hapin e parë, nxenesit do ta eksplorojnë problemin dhe do ta diskutojnë duke mësuar informacionet bazë në lidhje me ndryshimin e klimës nepermjet videove te ndryshme qe mesuesi mesuesi mundet te gjej ne internet ose ti krijoj vet. Për të zhvilluar të menduarit kritik, mësuesi u mësuesi u kërkon nxenesve që të plotësojnë këtë.

(Nëse doni të krijoni një mozaik me imazhe të tjera online, klikoni

[këtu](#)

<https://www.jigsawexplorer.com/create-a-custom-jigsaw-puzzle/>.

Plotësoni formularin e shkurtër dhe klikoni “Create the Jigsaw puzzle”. Mund ta ndani me me nxenesit duke ndarë me ta linkun që shfaqet poshtë “Short Link” në faqen e mëposhtme.)  
mëposhtme.)

Qoftë individualisht, qoftë në grupe me 2 - 3 veta, nxenesit e plotësojnë mozaikun me kompjuterët, tabletat ose smartfonët e tyre.

Pasi të gjithë nxenesit ta kenë plotësuar mozaikun, mësuesi fillon një diskutim duke u bërë nxenesve pyetje, të tilla si:

- Çfarë nënkupton kjo figurë për ju?
- Cilat janë problemet më të mëdha që hasin njerëzit anembanë botës sot për sa i përket ndryshimit të klimës?
- Si ndikon në jetën tuaj të përditshme ndryshimi i klimës?

Opsionale: mësuesi mund t'i ftojë nxënësit që të nxjerrin përfundime në bazë të opinionit të tyre dhe ta përdorin këtë [Forum](https://www.tricider.com/admin/3TaGCmYRMPH/BQCDAiZ6IHB). Pyetja është në anglisht.

<https://www.tricider.com/admin/3TaGCmYRMPH/BQCDAiZ6IHB>

1. Ka disa metodat te bashkëveprimit gjatë mësimit përmes TIK-ut.

Këto metoda realizohen psh.

- nxënës me nxënës,
- nxënësi me grupin dhe
- grupi me grupin.

Nxënësit mundën që gjithashtu të bashkëveprojnë me njerëz të ndryshëm, si me shokët e klasës ashtu dhe në shtëpi, mësuesin, nxënësit e klasave të tjera, nxënës nga komunitete të ndryshme dhe njerëz nga e gjithë bota.

(Kjo mundësohet gjatë mësimit I cili bazohet në projekte PBL). SHEMBULL

<https://www.canva.com/>





## *Shembull situate: A mund ta krijoni algoritmin tuaj?*

Në hapin e dytë, mësuesi i fton nxënësit që të krijojnë algoritme. Mund t'i përkthejmë efektet e ndryshimit të klimës në komanda duke përdorur logjikën e kodimit, pasi kodimin mund ta gjejmë në çdo aspekt të jetës.

Për diskutimin, mësuesi i pyet nxënësit se çfarë dinë në lidhje me algoritmet. Mësuesit mund të përdorin mjete të lira, si [Miro](#) ose [Mind Meister](#) për të krijuar një brainstorming; [këtu](#)

Së pari, mësuesi shpjegon se çfarë është një algoritëm në jetën e vërtetë.

Mësuesi u jep nxenesve një fjalë, për shembull “pemë”, dhe krijon një algoritëm me një fjalë, i cili përmban një “kusht” dhe një “pasojë”.

Për shembull:

*Çfarë ndodh nëse i presim pemët? Po nëse nuk presim (tjetër)? ->*

Nëse i presim pemët (kushti Boolean) atëherë përqindja e oksigjenit në ajër do të sasia e dioksidit të karbonit do të rritet (shprehjet kushtore). Tjetër (alternativë), presim pemët, do të kemi më pak dioksid karboni, dhe kjo do të sjellë më pak ndotje, shëndet më të mirë dhe më pak rrëshqitje dheu. Pastaj, pasi nxenesit të kenë kuptuar funksionon algoritmi, mësuesi jep disa fjalë të tjera dhe i nxit nxenesit që të krijojnë algoritmet e tyre.

Disa shembuj të fjalëve janë “rritja e nivelit të detit”, “ngrohja”, ose “shkrirja e Studentët mund t’i ndajnë me klasën ose brenda grupeve algoritmet e tyre.

## **Puna ne grup: Zhvillimi i bashkëpunimit efektiv**

<https://padlet.com/erikonomi180/ad1ovex5mek7qf18>

Ndani një fotografi që tregon ose përfaqëson bashkëpunimin për ju, së bashku me një shpjegim të shkurtër pse e keni zgjedhur këtë fotografi, teknikat e përdorura.

Ju lutemi, mos harroni gjithmonë të përmendni emrin tuaj, mbiemrin dhe vendin e origjinës. Komentet anonime nuk inkurajojnë dialogun.

2. Teknika të tjera janë kur mësuesit i zhvillojnë detyra të ndryshme, (gjatë mësimet në distancë) psh detyra dosje ose ushtrime, të cilat rrisin mundësinë e bashkëveprimit social sa më cilësor.

<https://padlet.com/erviolakonomio88o/Bookmarks>

Në mënyrë që të përfshihen të gjithë nxënësit e të jenë aktiv, mësuesi duhet t'ia caktojë secilit nxënës nga një rol specifik, që të gjithë nxënësit në grup të marrin pjesë edhe së bashku të arrijnë qëllimin e grupit.



Erviola Konomi




<https://padlet.com/erviolakonomio88o/e2n52dwtzty169da>

Kjo strukturë mundëson që nxënësit të kontaktojnë me njëri-tjetrin duke mësuar rreth temës në një lëndë të caktuar por dhe përdorimin e mjeteve digjitale.

Sa më shumë që të kenë nevojë për bashkëpunim, aq më shumë efektiv do të jetë bashkëpunimi.

Në këtë mjedis teknologjia shërben si mjet për të gjitha llojet e ushtrimeve (detyrave), që nga krijimi i faqeve të internetit deri në krijimin e portofoleve personale.

(shembull) <https://padlet.com/erviolakonomio880/e2n52dwtzty169da>



# Zgjedhje mbresëlënëse e botimeve dixhitale -Flip HTML5

## Faqen personale të jashtëzakonshme.

Automatikisht krijoni një faqe personale të jashtëzakonshme në FlipHTML5, duke e bërë më të lehtë për njerëzit të mësojnë rreth jush dhe të gjejnë botimet tuaja dixhitale.

Mbledh automatikisht të gjitha botimet tuaja dixhitale në një raft librash të bukur, i cili mund të futet lehtësisht në faqen tuaj të internetit. Për më tepër, ju jeni në gjendje të krijoni sa rafta librash të doni.


Nxenesit mundën ta lexojnë flipbook në iPad, iPhone ose pajisje të tjera iOS pa lidhje interneti me aplikacionin falas të iOS - Flip HTML5 Reader.

Ose skanojnë kodin QR më poshtë për të marrë aplikacionin:



<https://online.fliphtml5.com/wcbcx/igpl/>

Ndan postimet dixhitale në rrjetet sociale si FaceBook, Twitter, Google Plus. Kjo e bën më të lehtë shpërndarjen e flipbook dixhital për më shumë njerëz.




<https://fliphtml5.com/osvng/lsfy/basic>

## Praktik, demonstrimi i mjetit; Thinklink

<https://www.thinglink.com/user/902642290953027586>

Një shembull i përdorimit të teknologjisë janë simulimet nëpërmjet lojërave/ mjeteve kompjuterike ku nxënësit luajnë rolin e vendimmarrësit në situata historike në mënyrë që të shikojnë rëndësinë e këtyre ngjarjeve në jetën e tyre të përditshme dhe të zhvillojnë më mirë aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit.



Nxënësit, gjatë navigimit nëpër udhëtimin virtual, mundet tu përgjigjen pyetjeve të mësuesit.

Forma të tjera të përdorimit të teknologjisë janë dhe udhëtimet virtuale në kohë. Aplikacioni celular ThingLink është mënyra më e lehtë për të ruajtur dhe shkëmbyer shënime dhe vëzhgime në lidhje me hapësirat, situatat dhe artefaktet e botës reale. Ideale për klasën dhe librin e punës është regjistrimi i drejtpërdrejtë të zërit në fotot e kamerës!

Nxënësit mësojnë rreth kulturave të ndryshme duke parë fotografi, filma, videoklipe, prezantime në power-point dhe tekste të përzgjedhura.

3. Teknikë tjetër është prezantimi i punimeve. Nxënësit i prezantojnë punimet e tyre në klasat fizike/virtuale për t'i vlerësuar mësuesi/ja.

Mësuesi/ja duhet t'u paraqesë nxënësve arsye për të dëgjuar prezantimet si, për shembull, të bëjnë vlerësimin e prezantimeve të shokëve, të marrin shënime, që do t'u duhen për ndonjë kuiz apo test, ose të kërkohet ndonjë përmbledhje e prezantimit që ata dëgjuan".

Në këtë mënyrë mësuesi i inkurajon të gjithë nxënësit që të dëgjojnë dhe të japin përgjigjet e duhura.

3. **Padlet** <https://padlet.com/?ref=logo> program që shërben për të paraqitur materiale, diskutime si një dosje digjitale për punimet e nxënësve.





## Detyre grupi: Plotesoni PADLETIN

<https://padlet.com/erikonomi180/6psaswilulydhk1v>



**Pjesa e III. Vlerësimi i të nxënit (Të dish cfarë kanë mësuar nxënësit)**  
(Udhezuesi-me-situata-te-te-nxenit-me-TIKun, Tirane 2015)

Vlerësimi i mësimdhënies/nxënies (rezultateve të të nxënit) ndodh para, gjatë dhe pas mësimdhënies/nxënies duke ndihmuar mësuesin të vlerësojë së sa janë arritur rezultatet e të nxënit përcaktuar për atë orë mësimore nëpërmjet vlerësimit të performancës së nxënësve.

Mjetet/instrumentet e vlerësimit përfshijnë pyetjet me zgjidhje të shumëfishta, mini- teste, ese, detyra me shkrim, diskutime, vëzhgimet e mësuesit, aktivizimin e nxënësit në klasë, projekte, portofolin e nxënësit dhe performancën e nxënësit.

Këto instrumente vlerësimi sigurojnë të dhënat mbi atë çka nxënësit dinë dhe janë në gjendje të bëjnë si rezultat i mësimdhënies/nxënies.

Mjetet e teknologjisë që mbështesin **procesin e vlerësimit** dhe **vlerësimin e nxënësve** janë:

- Teste elektronike dhe kuiz-e  
(nuk ka te bej me testin, por me ate qe ndodhe pas testit)
- Portofoli digjital
- Anketime online.



## SHEMBULL TE NJE PLAN AKTIVITETI

<https://1drv.ms/b/s!ApVZHsX6tyRZz3wNe6l3B8dxylgh>

## 2. MJETI QUIZZIZ PER VLERËSIMIM E TË NXËNIT TË NXËNËSVE. PRAKTIKE

### Toolsa për pjesën e vlerësimit të nxënësi dhe prezantim të detyrave

1. **Quizizz** <https://quizizz.com> është një mjet shumë interaktiv përdoret për të kontrolluar njohurit paraprake ose të thelluara të nxenesve, për teste dhe miniteste në formën e lojes dhe është argetuese dhe e terheq të gjithë nxenesit kl<sub>1</sub>-kl<sub>12</sub>. Sistemi bën një analizë të rezultateve të kuicit pas të përgjigjeve, eidenton saktësinë në përqindje për klasën dhe individin për çdo ushtrim të testit. Nderkohe që nxënësi luante mesuesi merr feedbackun në kohë reale, duke parë progresin e nxenesit. Nxënësi motivohet pasi e shikon kuicin si një garë ku sistemi nxjerr dhe përzgjedh tre fituesit.
2. **Google Forms** për krijimin e testeve dhe kuiceve. Përdoret nga të gjithë mesuesit.
3. **Padlet** <https://padlet.com/?ref=logo> program që shërben për të paraqitur materiale, diskutime si një dosje digjitale për punimet e nxenesve.



1. [Canva](#)
2. [Google form](#)
3. [Google Maps, Docs and Drive](#)
4. [Kahoot!](#)
5. [Formative](#)
6. [Quizziz](#)
7. [Edpuzzle](#)
8. [Poll Everywhere](#)
9. [SoundCloud](#)
10. [insTuner](#)
11. [MuseScore](#)
12. [SmartMusic](#)

## Përse vlerësimi formues?

Sepse nxënësit që janë më të angazhuar, mësuesit që marrin reagime dhe ndërveprojnë me nxënësit e tyre dhe një proces mësimi dhe mësimdhënie që është shumë më kuptimplotë dhe i përafruar me sfidat e sotme në klasë

Në fakt, shumica e mjeteve mund të përdoren në një mënyrë formuese.

Prandaj, mendoni për mjetet tuaja të preferuara të mësimdhënies dhe të të nxënimit dhe merrni parasysh se si ato mund të përdoren për vlerësimin formues.

Kuizi tradicional mund të përdoret në një mënyrë formuese dhe mjetet që mund t'ju ndihmojnë me këtë

Stream Classwork People Grades

+ Create

Google Calendar Class Drive folder

### ORE MESIMORE

- derivati
- Detyrat e statistikes
- Detyrat e vektorit
- Ushtrime
- Pensurirje Teoremat e rrethit
- Pensurirje Inekuacionet
- Pensurirje per mature

Vlerësimi I vazhduar.

Stream Classwork People Grades

### Testi 2

- Testi i vjeshtes 2019
- Ush e testit te vijave te grades se dyte
- Testi klasa 12 B
- Matematik testi 2
- Testi qe ju lash te punonit sebashku me ske...
- detyra permbledhese ne matematike, deriv...
- Testi perjudha 2
- Testi

Vlerësimi me test.

Stream Classwork People Grades

### PORTOFOLI

Festivali etwinning Posted May 12

### MATERIALET E KLASES

- Libri i ushtrimeve.
- ZBATIMI I DERIVATIT NE JETEN NE SHKENCA
- ZBATIME

Vlerësimi I portofolit.

Stream Classwork People Grades

### PORTOFOLI

Festivali etwinning Posted May 12

0 Turned in 43 Assigned

Shkolla "Zhan Ciko" Ndry...  
<https://yedit.com/revizolako...>

View assignment

Erviola Konomi

## Si mundet te integrojme TIK si mjet pune ne mesimdhenie?

Mësuesit mund të gjejnë mënyra të ndryshme për integrimin e teknologjisë si mjet pune për nevoja arsimore, qoftë me përdorimin e pajisjeve të tyre personale si laptop, ipad, apo me shfrytëzimin e pajisjeve të kolegëve të tyre e në disa raste edhe kur vetë nxënësit sjellin në shkollë laptopat e tyre.

Mundet të përdoret një kompjuter dhe një videoprojektor për ta bërë orën e mesimit sa më tërheqëse. Po ka shkolla që kane klasa digjitale si dhe laboratore.





## DETYRAT E SHTEPISE DUKE PERDORUR TIK

Nga mësuesit kërkohet që gjatë procesit mësues të përdorin strategji të ndryshme të mësimit dhe nxënies. Mësimi bashkohor kërkon që të ketë llojshmëri të mënyrave për mësimnxënie.

Roli dhe rëndësia e TIK në mësim është shumë e madhe dhe integrimi i TIK-ut në detaje të shtëpisë bëjnë aktivizimin e drejtpërdrejtë dhe të pavarur të nxënësve për përfundimin e lëndës mësimore pa mbikëqyrje nga ana e mësimit për punën e planifikuar.

Për të integruar TIK-un për nevojat pedagogjike në shtëpi, gjithnjë kërkohet orientim dhe vlerësim nga mësuesit, si dhe mbikëqyrje nga prindërit.

Roli I përdorimit të TIK për detyrat e shtëpisë të nxënësve është shumë I rëndësishëm, për arsye se mundëson që nxënësit, përveç zgjidhjes së detyrave përmes librave, mund të përdorin edhe internetin, duke hulumtuar dhe duke zgjeruar njohuritë e tyre për një çështje apo lëndë mësimore.


**Përmes kësaj ata mund të mësohen se si të përdorin burime nga interneti.**

Psh <https://fliphtml5.com/> per krijimin e librit digital.

Gjithashtu ka disa sit-e në Internet që ofrojnë edhe përkthim të vizualizimit (applet-it) në gjuhën që dëshiron përdoruesi. I tillë është portali i krijuar nga Universiteti i Kolorados (SHBA) <http://phet.colorado.edu/> ku mësuesit e Matematikës, Fizikës, Kimisë dhe Biologjisë mund të gjejnë dhe shkarkojnë falas shumë vizualizime, që ofrojnë pamje dhe veprime interaktive tërheqëse për nxënësit.

Ky portal ofron falas edhe mundësinë që shfaqjet e demonstrimit të kenë shkrime shqip apo në çdo gjuhë. <https://www.youtube.com/watch?v=KoI81cVOCRg>

Ka një udhëzim në këtë portal për përkthyesit “translators”. <http://phet.colorado.edu/en/fortranslators/translation-utility>



Procesi i mësimdhënies/nxënies është I rëndësishëm si në lëndët e shkencave dhe shoqërore, për integrimin e vazhdueshëm të TIK-ut në fushën e arsimit.

Nxënësit bazën e arsimit e marrin nga shkolla fillore dhe ajo e ciklit të mesëm të ulët. Po ashtu mësimdhënësit e këtij niveli që në fillim të fëmijërisë së hershme të nxënësit duhet t'i përgatisin, që ata të përdorin sa më drejt teknologjinë informative të komunikimit.


## INTERNETI

Teknologjitë e komunikimit janë mjete elektronike të cilat përdorin kompjuterin dhe internetin për të bërë të mundur shkëmbimin e shpejtë të informacionit ndërmjet njerëzve.

Roli i mësimdhënësve në këtë rast është orientues, ata mund të kërkojnë nga nxënësit hulumtime në internet për tema të caktuara mësimore, në mënyrë që t'i stimulojnë që internetin ta përdorin për nevoja pedagogjike.

Nga mësimdhënësit kërkohet që t'i nxisin nxënësit për kërkime në internet për informacione rreth një teme, demonstrime përmes videove, vjersha, tregime dhe shkrime të shkurtra letrare ose joletrare, etj.

Nxënësit të ndarë në grupe të vogla mund të lexojnë të analizojnë dhe të diskutojnë psh për revista, gazeta, artikuj kontradiktorë, për të cilët kanë interesim të gjithë dhe që kanë hasur në internet. Psh storytelling



**RUBRIKA E DISKUTIMIT.** Pyetsor për mësuesit:  
<https://forms.gle/w6d1JahDqrijmNp816>

Për çfarë u kërkojmë nxënësve të hulumtojnë në internet?



- Krahasuar me mësuesit, nxenesit duket se janë disi më pak të sigurt në kryerjen e veprimeve mjaft bazike, detyra të tilla si prodhimi i një skedari teksti. Nxenesit duket se janë më të sigurt se mësuesit në lidhje aplikacione për kodim dhe programim, programe ose robotë

- Sa i përket krijimit të përmbajtjes dixhitale, mësuesit ndihen më të sigurt me aktivitetet themelore (p.sh. duke prodhuar tekste) ndërsa ndihen më pak të sigurt në detyra më komplekse (p.sh. kodimi)

<https://codeweek.eu/training>

## Si te perdorim internetin për arsimimin e nxenesve?

Disa, nga nxënësit në internet paraqesin materiale të ndryshme, që janë të ndaluara dhe të papërshtatshme për moshën e tyre. Me qindra-mijëra adresa, shumica të pakontrolluara, hedhin materiale nga më të ndryshmet, në të cilat ka raste kur ekspozohet edhe dhunë për shkak të lojërave të ndryshme.

Adresa të ngjashme kanë tërhequr një numër të madh të të rinjve, që shikojnë në këto faqe dhe kjo mund të ketë pasoja të mëdha.

Interneti është revolucion elektronik që krahas anëve të veta pozitive, ka edhe anët e veta negative.

Kryesisht, interneti nga të rinjtë po përdoret për qëllime argëtuese, që shpesh janë edhe me pasoja të natyrave të ndryshme.





Ndryshime padyshim po shkaktjnë efekte të ndryshme te nxënësit, duke filluar nga dëshira e madhe për të hulumtuar në rrjetë, qëndrimi i gjatë para kompjuterit, e deri te humbja e interesimit të tyre për mësim dhe largimi i vëmendjes nga shkolla.

### **Anet pozitive:**

Nxenesit e perdorin per qellime mesimi.

E perdorin per informacione te reja, sepse gjate zhvillimit te temes mesimore nxenesit shpesh gjate ores kontribuojne me informacione te reja te marra nga interneti. Per informacione te ndryshme ne fusha te ndryshme.

### **Anet negative:**

Nxenesit e perdorin shume pak internetin per mesim, ata me tepër e perdorin per

- komunikim midis tyre
- per lojera.
- Per Facebook.
- Per lojera.

Nxenesit, duke filluar nga klasat e ulëta, duhet te jene ne gjendje qe te kerkojne informacione ne menyre te detajuar dhe te praktikojne me shume njohuritë dhe aftësitë e tyre per te qene njohës me te mire te specifikave kompjuterike. Nxenesit filloje qe ne klase te 6 te njohin edhe permbajtjen e Excel-it.

Në klasën e shtatë I kushtohet rëndësi aftësive bazë dhe mësuesit i kerkojne nxenesve te thellojne te kuptuarit e tyre.

Mësimi përmes kompjuterit mund të zhvillohet edhe në shtëpi me udhëzimet e mesuesve, mirëpo kërkojmë nga prindërit e nxënësve, që të vëzhgohen fëmijët e tyre me vëmendje, për atë se sa kohë dhe për çfarë po e përdorin kompjuterin.

Po ashtu kërkojmë nga prindërit që t'iu kufizohet koha dhe të jenë nën kontroll të tyre, për arsye se kanë vënë re ne gjatë procesit mësimor se ata janë duke e keqpërdorur kompjuterin, sidomos duke e humbur kohën në facebook.

**DISKUTIM:** <https://forms.gle/ppRyDc484o6GJmgM8>

Përse do ta përfshini teknologjinë mësimore në mësimdhënie pas ketij trajnimit?

A blue-tinted photograph of a person's hands raised in a gesture, with a laptop and a smartphone on a desk in the foreground. The text "FALEMINDERIT!" is overlaid in a white box with red text.

FALEMINDERIT!

Erviola Konomi

